

**PLATFORMA DHE VIZIONI
ZHVILLIMOR I UNIVERSITETIT
TË MJEKËSISË, TIRANË
2024 - 2028**



Prof. Dr. Xheladin DRAÇINI

KANDIDATI PËR REKTOR UMT



PLATFORMA DHE VIZIONI ZHVILLIMOR I UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË 2024 - 2028

**KANDIDATI PËR REKTOR
PROF. DR. XHELADIN DRAÇINI**

Të nderuar pedagogë dhe profesorë të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë!
Të dashur studentë të gjithë cikleve të studimit!

Kam kandiduar për pozicionin e Rektorit sepse besoj fort në aftësinë tonë të përbashkët për të përballuar sfidat që na presin në të ardhmen. Në 29 vitet që kam nderin të jem kolegu Juaj; i jam përkushtuar institucionit duke e konsideruar veten me fat të jem pjesë e Tij dhe kam bindje të plotë se çdo anëtar i stafit akademik të universitetit përfaqëson një aset të çmuar dhe të pazëvendësueshëm në realizimin e misionit tonë fisnik, mësimdhënien e shkencave të shëndetit.

Tashmë në vitin e njëmbëdhjetë të UMT-së me historik të shtrirë në shtatë dekada, besoj se ka ardhur koha të kalojmë në etapën e re zhvillimore si një institucion ekselent i plotësimit akademik, profesional dhe personal të stafit pedagogjik dhe studentëve bazuar në autonominë universitare dhe respektin reciprok; mbështetur në mjedisin e përbashkët harmonik të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor e inovacionit.

Në qindra takime me Ju muajt e fundit duke shkëmbyer ide dhe vizione si pjesë e inteligjencës kolektive universitare, jam plotësisht i bindur se prioritetet e punës në universitet dhe vizioni zhvillimor i së ardhmes duhen lidhur fort me parimin e 'Universitetit të bazuar në njerëzit' me përparësi të qartë zhvillimin e karrierës së stafit akademik dhe studentëve duke synuar mirëqenien dhe formimin e tyre elitare në hapësirën pedagogjike të arsimit të lartë mjekësor.

Synimi ynë do të jetë zhvillimi i UMT-së si një mjedis ideal për kolegët e përkushtuar, ku do të mund të shpalosin potencialin e tyre të plotë njerëzor e profesional të mësimdhënies dhe kujdesit shëndetësor bashkëkohor.

Mendimet dhe sugjerimet Tuaja ishin një ndihmesë e çmuar për hartimin e projektit zhvillimor gjithëpërfshirës për UMT dhe Ju falenderoj me mirënjohje për çdo ide dhe propozim. Ju siguroj se stafi universitar dhe studentët do të jenë gjithnjë në qendër të punës dhe vëmendjes tonë; ndërkohë uroj për gjithë secilin shëndet; suksese e mbarësi në të gjitha nismat e projektet të tashme e të ardhme,

Me respekt e konsiderate të lartë,

Prof. Dr. Xheladin DRAÇINI

Kandidat për Rektor i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë

Vizioni zhvillimor i UMT për katër vitet e ardhshëm, bazohet në këto objektiva kryesorë:



Ndërkombëtarizim të UMT-së, si pjesë e dialogut global me shoqërinë bashkëkohore;



Harmonizim në nivel ekselence mësimdhënies në të treja ciklet e studimeve;



Kërkim shkencor inovativ në fushat prioritare të kujdesit shëndetësor;



Mjedis universitar miqësor nëpërmjet informatizimit të procedurave akademike dhe administrative, si edhe mbështetjes së stafit universitar.

Objektivi nr. 1

NDËRKOMBËTARIZIMI I UMT-SË, SI PJESË E DIALOGUT GLOBAL ME SHOQËRINË BASHKËKOHORE.

**“PËR NJË
UNIVERSITET TË
GATSHËM PËR T’U
PËRBALLUR ME
SFIDAT E SË
ARDHMES”**



Ndërkombëtarizimi përfshin proceset që synojnë integrimin e vlerave dhe praktikave globale, ndërkombëtare dhe ndërkulturale në objektivat dhe përmbajtjen e arsimit të lartë mjekësor dhe prek të gjithë nivelet dhe aktorët (studentë, pedagogë, staf administrativ) e tij.



Institucionet e arsimit të lartë mjekësor synojnë natyrshëm ndërkombëtarizimin si mjetin më të mirë për rritjen e cilësisë së studimeve dhe kërkimit shkencor.

**“MOBILITET – PROJEKTE TË KËRKIMIT
SHKENCOR – PARTNERITET
NDËRKOMBËTAR”**


Prioriteti ynë nr. 1 është rritja e pranisë globale në hapësirën evropiane të arsimit të lartë mjekësor.

- Hartimin e strategjisë të ndërkombëtarizimit të UMT-së në kuadër të punës së përbashkët me gjithë grupet e interesit për implementimin e Politikave Kombëtare të Ndërkombëtarizimit të IAL-ve.
- Rritjen vazhdueshme të partneritetit dhe bashkëpunimit me universitetet e huaja të hapësirës evropiane të arsimit të lartë.
- Forcimin vazhdueshëm të partneritetit të UMT-së me programet e shkëmbimit ERASMUS.
- Rritjen dhe mbështetjen institucionale të shkëmbimeve studimore të pedagogëve dhe studentëve me institucionet e huaja të arsimit të lartë.
- Aplikimin në shkallë të gjërë të mobiliteteve ndërkombëtare në formën e doktoraturave të përbashkëta ose me ko-tutelë.
- Prezantimin e formave innovative të mobiliteteve digjitale (virtuale), ose si formate hibride të mobiliteteve fizike/virtuale në të tre ciklet e studimeve në UMT.
- Fillimin e punës për implementimin e kurrikulës të programeve të studimit në gjuhën angleze për tërheqjen e studentëve të huaj në UMT.
- Rritjen e pjesëmarrjes të pedagogëve, studentëve dhe stafit administrativ në aktivitete, konferenca dhe trajnime ndërkombëtare, duke parashikuar edhe mbështetje financiare institucionale për këtë qëllim.
- Rritjen e vizibilitetit të UMT-së dhe aktiviteteve universitare nëpërmjet përmirësimit të Website dhe publikimeve të aktiviteteve në gjuhën angleze.
- Rritjen e pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare të kërkimit shkencor të stafit akademik dhe studentëve.
- Rritjen e bashkëpranisë së UMT-së në konferenca, projekte dhe aktivitete ndërkombëtare, duke parashikuar edhe mbështetje financiare institucionale.
- Ngritjen e Qendrës së Gjuhëve të Huaja pranë UMT-së për të trajnuar dhe përditësuar falas stafin akademik dhe mbështetur mësimdhënien për studentët.
- Përmirësimin e vazhdueshëm të infrastrukturës së kërkimit shkencor dhe vijimin e projektit madhor të Qendrës Multifunksionale të Simulimit Klinik.
- Ngritjen e platformave digjitale të informatizuara të komunikimit në funksion të strategjisë së mësipërme të ndërkombëtarizimit në UMT.

Objektivi nr. 2

HARMONIZIMI NË NIVEL EKSELENCE I MËSIMDHËNIES NË TË TRE CIKLET E STUDIMIT.

**“STUDENTËT TANË
MERITOJNË
MËSIMDHËNIEN MË
TË MIRË PËR T’U BËRË
PROFESIONISTË TË
DENJË NË SHKENCAT
E SHËNDETIT”**



Universiteti i Mjekësisë, Tiranë kontribuon nëpërmjet asimilimit të dijeve dhe krijimit të njohurive të reja në zhvillimin e shkencave të shëndetit në hapësirën akademike shqiptare dhe më gjërë. Vitet e fundit UMT-ja po përballlet me sfidën e rëndësishme të shtimit të numrit të studentëve në përgjigje të nevojave në rritje të sistemeve të kujdesit shëndetësor.



Këtë sfidë e vlerësojmë si një mundësi reale për të rinovuar, harmonizuar dhe përditësuar programet e studimit dhe rritur forcën e potencialin akademik të universitetit.

**“SHOQËRIA PRET REZULTATE KONKRETE NGA
UNIVERSITETET DHE KËRKON TË SHOHË
IMPAKTIN E TYRE; PRANDAJ DUHET TË KEMI
VULLNET TË QËNDRUESHËM PËR TË MËSUAR,
DHE PËRDITËSUAR DIJET”**

Për harmonizimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies në UMT propozojmë masat e mëposhtme:

- Promovimin e metodologjive të mësimdhënies që stimulojnë kreativitetin e studentëve nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në studime shkencore dhe projekte zhvillimore, studimit të personalizuar etj.
- Rinovimin e vazhdueshëm të kurrikulave universitare në drejtim të rritjes së aftësive praktike dhe metodologjisë së kërkimit shkencor.
- Rritjen e qëndrueshme të numrit të studentëve në të gjithë programet e studimit në përputhje me kërkesat e shtuara të sistemeve të kujdesit shëndetësor.
- Shtimin e numrit të pedagogëve efektivë për përballimin me cilësi të ngarkesës mësimore të shtuar.
- Ristrukturimin e burimeve njerëzore të stafit akademik dhe ndihmës akademik e administrativ në përgjigje të rritjes së numrit të studentëve në universitet.
- Fillimin e punës për projektin e Kampusit të Rinovuar të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, që përfshin edhe vijimin e projektit madhor të Qendrës Multifunkionale të Simulimit Klinik.
- Harmonizimin e mësimdhënies të shkencave bazë mjekësore për të gjitha programet e studimit të UMT-së.
- Krijimin e një hapësire të përbashkët universitare për promovimin doksoral dhe akademik në kuadër të harmonizimit të programeve të studimit të ciklit të tretë dhe mbështetjes së vazhdueshme të personelit akademik.
- Fillimin e punës për projektin zhvillimor të 'e-universitetit' mbi digjitalizimin e pjesshëm të procesit mësimor me fokus në aplikimet e Inteligjencës Artificiale (AI), materialeve didaktike digjitale online, simulimin klinik në aftësimin praktik, e-laboratorët, edukimin në distancë, Telemjekësinë dhe Teleshëndetin, tutorialet e ndryshme etj.
- Prezantimin e ciklit të studimeve post-doktorale sipas tematikës së përzgjedhur bashkëkohore të fushave prioritare të kërkimit shkencor në shkencat e shëndetit.
- Fuqizimin e vazhdueshëm të Qendrës së Zhvillimit Profesional në UMT për ofrimin e programeve të qëndrueshme të Edukimit në Vazhdim dhe Të Mësuarit Gjithë Jetën për profesionistët e shkencave të shëndetit.

Objektivi nr. 3

KËRKIM SHKENCOR INOVATIV NË FUSHAT PRIORITARE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

**“UNIVERSITETI I
MJEKËSISË, TIRANË
PROMOVON KËRKIM
SHKENCOR TË
PAVARUR, INOVATIV
DHE AFATGJATË!”**



Universiteti i Mjekësisë, Tiranë synon të rrisë sasinë, cilësinë dhe efektivitetin e kërkimit shkencor në shkencat e shëndetit; kërkim që kontribuon për të zgjeruar kufijtë e dijes ndërmjet disiplinave mjekësore, duke qenë i pranishëm në projektet kombëtare dhe ndërkombëtare.




**“PARIMI YNË KRYESOR MBETET
TRANSFORMIMI I DIJES DHE SHKENCËS
MJEKËSORE NË INOVACIONE, PROJEKTE DHE
PRODUKTE NË SHËRBYM TË PACIENTËVE,
SHOQËRISË DHE NJERËZIMIT!”**

Për të mundësuar ofrimin e kërkimit shkencor me cilësi të lartë, si pjesë e pandarë e mësimdhënies dhe kujdesit shëndetësor, propozojmë masat dhe nismat e mëposhtme:

- Ruajtjen e rritjes së qëndrueshme të publikimeve shkencore të stafit akademik të UMT-së në periodikët shkencorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë.
- Implementimin e projekteve të investimeve në infrastrukturën e kërkimit shkencor (laboratorë, baza të dhënash informatike, instrumenta shkencorë etj.).
- Rritjen e kapaciteteve të shkrimit dhe hartimit të projekteve në UMT me fokus kërkimin shkencor në shkencat e shëndetit.
- Krijimin e Grupeve Akademike Klinike (GAK), si forume tematike për kërkimin dhe kërkuesit shkencorë ndërmjet disiplinave mjekësore për të përmirësuar bashkëveprimin midis kërkimit shkencor bazë dhe klinik, me synim forcimin e bashkëpunimit me ofruesit e kujdesit shëndetësor.
- Lehtësimin, brenda kuadrit ligjor në fuqi, të procedurave të nevojshme administrative të aplikimit në grantet dhe projektet e kërkimit shkencor.
- Rritjen e vizibilitetit të kërkimit shkencor në UMT nëpërmjet ndërkombëtarizimit dhe publikimeve shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare të stafit akademik.
- Rritjen e pjesëmarrjes së UMT-së në projekte rajonale dhe ndërkombëtare që lidhin kërkimin shkencor me edukimin mjekësor; duke nxitur kërkimin shkencor me vlera për pacientët dhe shoqërinë në përgjithësi.
- Fillimin e punës për projektin e ngritjes në universitet të një Qendre të Studimeve Post-doktorale sipas fushave kryesore të kërkimit shkencor në shkencat e shëndetit.
- Mbështetje financiare dhe infrastrukturale për stafin akademik dhe studentët për projektet e kërkimit shkencor në shkencat e shëndetit.
- Përmirësimin e vazhdueshëm të infrastrukturës të bibliotekave shkencore fizike dhe virtuale në UMT në drejtim të pasurimit me literaturë mjekësore bashkëkohore.
- Publikimin në gjuhën angleze të gjithë revistave shkencore në UMT me synim rritjen e vizibilitetit të kërkimit shkencor.

MJEDIS UNIVERSITAR MIQËSOR NËPËRMJET INFORMATIZIMIT TË PROCEDURAVE AKADEMIKE E ADMINISTRATIVE DHE MBËSHTETJES SË STAFIT UNIVERSITAR

**“UMT SYNON PËRMIRËSIMIN
DHE MBËSHTETJEN E
ZHVILLIMIT TË KARRIERËS SË
KOMUNITETIT UNIVERSITAR
MJEKËSOR, SI EDHE FUQIZIMIN
E KARRIERAVE INDIVIDUALE
NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË
KULTURE INSTITUCIONALE TË
MBËSHTETUR NË BESIMIN E
NDËRSJELLTË.”**



Universiteti i Mjekësisë, Tiranë synon të krijojë një atmosferë miqësore dhe empatike për pedagogët, studentët dhe stafin ndihmësakademik dhe administrativ, duke përcjellë vlera konstruktive dhe bashkëpunuese. Impakti pozitiv që UMT-ja ka në shoqëri lidhet me punën e madhe të suksesshme të lektorëve tanë, stafit administrativ dhe studentëve. Për ne, prioriteti kryesor është mirëqenia e komunitetit universitar në mjedisin e punës dhe mësim, si edhe realizimi individual i karrierës së tyre.

**“UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË DUHET TË KETË
NJË MJEDIS EKSELENT DHE TË SIGURTË TË MËSUARI, SI
EDHE NJË KULTURE ETIKE QË PËRKUJDESET AKTIVISHT
PËR STUDENTËT DHE STAFIN UNIVERSITAR; DUKE U
KTHYER NË NJË INSTITUCION GJITHËPËRFSHIRËS DHE
MËSIMNXËNËS QË LEHTËSON PJESËMARRJEN DHE
KOMUNIMIKIN.”**

Më poshtë po rendisim disa prioritete strategjike në drejtim të mbështetjes institucionale për komunitetin universitar:

- UMT-ja do të lehtësojë zhvillimin akademik dhe profesional të karrierës së stafit akademik dhe administrativ, duke u fokusuar në planet individuale të karrierës dhe planin e masave të përgjithshme për ndërtimin e karrierës.
- UMT-ja në mënyrë të përshkallëzuar do të implementojë metodat innovative të të mësuarit digjital ('e-learning') dhe do të prezantojë një platformë digjitale unike ('e-universiteti') për të gjitha llojet e aplikimeve, si në fushën akademike, ashtu edhe për procedurat administrative.
- UMT-ja synon të mbështesë jo vetëm karrierën individuale, por edhe të përkujdeset për mirëqenien kolektive dhe komunikimin e ndërsjelltë empatik mes kolegëve, stafit administrativ e studentëve; në respekt të individualitetit dhe etikës institucionale.
- Zyrat e Karrierës në UMT do të mbështesin aktivisht në nivel individual dhe kolektiv planet e zhvillimit të karrierës për stafin universitar dhe studentët.
- UMT-ja synon mbështetjen financiare të stafit akademik sipas kuadrit ligjor në fuqi duke e shtrirë biapartenencën me sistemet e ofruesve të kujdesit shëndetësor për të gjithë pedagogët e universitetit.
- Përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të ushtrimit të aktivitetit akademik e profesional të stafit universitar nëpërmjet hapjes së universitetit ndaj shoqërisë, duke shfrytëzuar të gjitha burimet financiare ligjorë si psh. projektet inovative, partneritetin publik-privat, donacionet, etj.
- Zhvillimin e mbështetjes financiare për studentët e të gjitha cikleve të studimit, duke i përfshirë sipas kuadrit ligjor në fuqi në shërbimet administrative dhe punën universitare në përgjithësi.
- Përfshirjen në shkallë të gjërë të stafit akademik, administrativ dhe studentëve në projektet e kërkimit shkencor me financime rajonale dhe ndërkombëtare.

PLATFORMA ZHVILLIMORE PËR STUDENTËT UMT (2024 – 2028)

**“TË DASHUR STUDENTË;
MISIONI I UMT-SË PËRFSHIN
OFRIMIN E EDUKIMIT DHE
KËRKIMIT SHKENCOR EKSELENT
NË SHKENCAT E SHËNDETIT,
NDËRKOHË JU
REKOMANDOJMË TË NJIHNI
VLERAT TUAJA; TË NJIHNI
FAKTIN QË MERITONI MË TË
MIRËN E GJITHÇKAJE DHE
SHUMË SUKSES, NË RESPEKT TË
VLERAVE TË LARTA ETIKE DHE
PROFESIONALE TË
INSTITUCIONIT TONË.”**



Ndërkohë që shoqëria shqiptare vlerëson shumë shkencat e shëndetit dhe tashmë prej vitesh në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë pranohen studentët më të mirë në nivel kombëtar dhe më gjërë; jemi të ndërgjegjshëm se studentët tanë mund t’u përkushtohen plotësisht studimeve vetëm kur ju plotësohen nevojat e tyre jetike bazë.



**“RINOVIMI I VAZHDUESHËM I UNIVERSITETIT
TË MJEKËSISË, TIRANË KËRKON PËRFSHIRJEN
E QËNDRUESHME DHE ZHVILLIMIN
PROFESIONAL TË STUDENTËVE TË TALENTUAR
DHE EKIPEVE TË KËRKUESVE SHKENCORË TË
RINJ.”**

Universiteti duhet të mbështesë aktivisht studentët me të ardhura modeste dhe mundësi të pakta; duhet të promovojë studentët e shkëlqyer dhe të përfshijë sa më shpejt studentët në kërkimin shkencor, mësimdhënien dhe aktivitetet e punës e zhvillimit universitar, sipas planit të masave të mëposhtme:

- Pjesëmarrjes së shtuar të studentëve të tre cikleve të studimit në projektet e kërkimit shkencor të fushave prioritare të shkencave të shëndetit.
- Përmirësimit të vazhdueshëm të kurrikulës universitare në drejtim të rritjes së përqindjes të praktikave klinike, laboratorëve dhe punës së pavarur të studentëve.
- Ofrimit të mësimdhënies të bazuar në praktikën klinike universitare dhe kërkimin shkencor në fushat prioritare të shkencave të shëndetit.
- Përgatitjes së rinovimit të kurrikulës universitare të shkencave të shëndetit me fokus në rritjen e numrit të studentëve në të gjitha programet e studimit në UMT.
- Ofrimit në nivel universiteti të Kurseve të Aftësive Klinike mbi bazën e modeleve më të mira bashkëkohore, për të mundësuar aplikimin e studentëve në sistemet e ofruesve të kujdesit shëndetësor gjatë kohës së studimeve.
- Krijimin e një hapësire të përbashkët për Aftësimin Klinik për të gjithë studentët e universitetit mbi parimin e mundësive të barabarta dhe shtrytëzimit të përbashkët të infrastrukturës universitare.
- Organizimin e Internshipeve dhe Kurseve të Formimit Profesional për studentët në bashkëpunim e marrëveshje me sistemet e ofruesve të kujdesit shëndetësor.
- Strukturimin në nivel universiteti të Grupeve Shkencore të Studentëve sipas fushave prioritare të kërkimit shkencor në shkencat e shëndetit.
- Fillimin e bashkëpunimit me autoritetet shtetërore në drejtim të aplikimit dhe fuqizimit të skemave të Kredisë Studentore për mbështetjen financiare të studentëve.